



Kolegji ESLG



KRG-Kosova Realty Group L.L.C

## MEMORANDUM PËR BASHKËPUNIMI DHE NJOHJE TË NDËRSJELLËTË

NDËRMJET

Kolegjit "ESLG"- Prishtinë

dhe

KRG-Kosova Realty Group L.L.C

### Qëllimi i Memorandumit

1. Qëllimi kryesor i Memorandumit është ndërlidhja e studimeve me kërkesat e tregut të punës arritjen e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare në sektorin vlerësimeve të pronave të paluajtshme. Përmirësimi i ndërlidhjes ndërmjet shkathësive të fituara në arsim dhe kërkesave të tregut të punës, gjithashtu është edhe prioritet i Strategjisë Kombetarë për Zhvillim Ekonomik 2016-2021, e cila është identifikuar si një prej pengesave kryesore për rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik në vend. Rreth 25% të firmave në Kosovë ende ankohen se fuqia punëtore ka shkathësi të mangëta dhe të papërputhshme me nevojat e tyre. Kjo do të thotë se një student pas përfundimit të kolegjit ka shkathësine e fituara me punen praktike dhe vlerësimet praktike sipas standardeve dhe me nevojat e tregut të punës e cila do të ndihmojë në rritjen e punësimit, investimeve, të ardhurave dhe rritjen e ndërmarrjeve ekzistuese. E gjithë kjo do të mundësojë rritje më të lartë ekonomike dhe zhvillim më të qëndrueshëm.
2. Me këtë Memorandum palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar arritjen e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare në sektorin vlerësimeve të pronave të paluajtshme dhe me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të njohurive profesionale të studentëve dhe profesorëve dhe duke synuar ndërlidhjen e mësimit akademik në ESLG me punën praktike.



## I. Fushëveprimtaria

Bashkëpunimi i ndërsjellët i palëve do të realizohet në këto fusha:

1. KRG-Kosova Realty Group L.L.C zotohet se do të ofrojë këshillat e saj për përpilimin e planprogrameve moderne të lëndëve përkatëse në programin Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës niveli bachelor dhe niveli master;
2. KRG-Kosova Realty Group L.L.C zotohet se do të ofrojë praktikën për studentët e programit Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (BA) dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (MA);
3. Kolegji ESLG zotohet se do të udhëzojë studentët që të kryejnë praktikën obligative në kuadër të KRG-Kosova Realty Group L.L.C;
4. Kosova Realty Group L.L.C zotohet se do të inkurajojë stafin e vet që të kryejnë studimet master në programin Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (MA);
5. Stafi akademik i Kolegjit ESLG ofron ndihmën këshilldhënëse për KRG-Kosova Realty Group L.L.C dhe gjithashtu do të bashkëpunojnë në hulumtime dhe analiza të përbashkëta të cilat janë në favor të sektorit privat;
6. Organizimi i përbashkët i aktivitetave në fusha të ndryshme nëpërmjet simpoziumeve, konferencave, debateve rreth standardeve dhe praktikave më të mira në fushën e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare të vlerësimit të paluajtshmërive;
7. Qasje në projekte të ndërsjellta, nëpërmjet të cilave do t'u mundësohet pedagogëve, studentëve dhe stafit udhëheqës dhe menaxhues, të kenë mundësi të përfshihen në projekte të përbashkëta që do të ndërmerren nga Kolegji "ESLG" dhe KRG-Kosova Realty Group L.L.C;
8. Konkurrimi në projekte të përbashkëta vendore, ndërkombëtare, nëse ndërmjet palëve ekziston vullneti dhe dëshira.

## II. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërsë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër.
2. Palët do të përdorin dhe trajtonë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri/konfidencialitet të plotë.



### III. Dispozitat e

1. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim apo keqinterpretim në realizimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet në fryshtë e tolerancës, mirëkuptimit dhe brenda kuadrit të etikës morale;
2. Ky Memorandum hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit;
3. Ky Memorandum është përpiluar në katër kopje identike, dhe secila palë merë nga dy kopje.

Prishtinë, më 25.04.2016

### PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji "ESLG"  
Kryetari Bordit  
Dr. Visar Hoxha



KRG-Kosova Realty Group L.L.C  
CEO  
Vlerësues i Certifikuar Gent Sejdiu



